



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.02.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të komisionit.
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 23 dhe 24 janar 2019.
3. Projektligji “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.
4. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Alket Hyseni, Klajda Gjasha, Ditmir Bushati, Nard Ndoka, Tritan Shehu dhe Alket Hyseni

Mungojnë:

Edi Paloka, Klevis Balliu, Edmond Panariti dhe Rudina Hajdari

Të ftuar:

Artemis Dralo – zëvendësministre për Europën dhe Punët e Jashtme

Petro Koçi – zëvendësministër i Mbrojtjes

Armand Skapi - Drejtor i Traktateve në MEPJ

Ilir Melo - Drejtor i Drejtorisë së Rajonit dhe Vendeve Fqinje në MEPJ

Petrit Çuni - Drejtor i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së

Gjergji Methoxha - Drejtor i Drejtorisë së Politikave në NATO dhe BE në Ministrinë e Mbrojtjes

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme.

Përpara se të filloj me rendin e ditës, i uroj mirëseardhjen në gjirin e këtij komisioni zotit Ditmir Bushati! Mirë se erdhët zoti Bushati në komision!

Sot në rendin e ditës kemi: miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit. A keni ndonjë gjë për kalendarin? Nuk keni.

Miratohet.

Po ashtu në rend dite edhe miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të datave 23 dhe 24 janar 2019. A keni ndonjë vërejtje për procesverbalet? Nuk kemi.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në një projektligji shumë të rëndësishëm, projektligji “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Përpara se t’jia jap fjalën zëvendësministrit të Mbrojtjes, zotit Petro Koçi, dhe zonjës Artemis Dralo, zëvendësministre për Punët e Jashtme dhe Europën, dua të theksoj se ky është një projektligj i një rëndësie të veçantë. Shpresoj që Shqipëria të jetë ndër të parat vende që do ta miratojë apo ratifikojë këtë protokoll, sepse flitet për një vend fqinj, flitet për një vend të rajonit me një përqindje të konsiderueshme shqiptarësh, flitet për një proces për të cilin Maqedonia e Veriut ka luftuar dhe punuar fort. Për shkak të emrit ka pasur një pengesë, dhe patjetër që do ta diskutojmë sot, e cila tashmë është tejkaluar.

Pas 10 vjetësh përpjekje për të mbërritur aty ku, në fakt, Maqedonia e Veriut mbërrin sot, ne thjesht dhe vetëm, si mbështes që kemi qenë, do të vazhdojmë të jemi ndër të parët që me ratifikimin e këtij protokoll, do të tregojmë se realisht e kemi për zemër këtë rajon, sigurinë, mbarëvajtjen dhe rrugën euroatlantike të të gjitha vendit.

Tritan Shehu - Zonja kryetare, dua të di se cili është komisioni kryesor për këtë marrëveshje dhe në bazë të përgjigjes suaj kam komentet e mia.

Mimi Kodheli – Për procedurë do t’ju jap një përgjigje dhe më pas do të dëgjojmë zëvendësministrat dhe relatorin. Më pas kemi pyetje dhe komente...

Tritan Shehu – Kjo ka të bëjë me rendin e ditës dhe me procedurën, para se të fillojë mbledhja, sepse për shembull, mbledhja mund të konsiderohet nul.

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, ju mbledhjen nuk e konsideroni dot nul...

Tritan Shehu – E konsideron Rregullorja e Kuvendit.

Mimi Kodheli – Besoj se në rastin e praktikës të ndjekur pothuajse 2 vjet më parë, ku vendet anëtare firmosën protokollin e Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Malit të Zi në NATO, Shqipëria ka qenë i pari parlament që ka e ratifikuar këtë protokoll dhe komisioni përgjegjës ka qenë Komisioni i Sigurisë. Në atë kohë Kryetar Kuvendi nuk ka qenë zoti Ruçi, por të tjerët e kanë menduar se duhet të ishte kështu.

Zoti Shehu, edhe unë ndaj të njëjtin opinion me ju që, në fakt, Komisioni për Politikën e Jashtme duhet të ishte komisioni përgjegjës. Megjithatë është e rëndësishme që ky komision, pavarësisht se është komision për dhënie mendimi, ka të gjithë tagrin, detyrimin që ta konsiderojë këtë projektligj si një komision përgjegjës, nuk besoj se ka ndonjë dallim të madh. Kështu, mendoj që pas një diskutimi konstruktiv dhe shterues, që ju do të bëni, mund ta kalojmë ashtu siç është edhe në traditën e këtij komisioni.

Gjithsesi besoj se është për shkak të faktit se edhe në rastin e parë është ndjekur kjo rrugë dhe mendoj se nuk e kanë menduar më shumë se kaq. Unë kam bërë kërkesën time në këtë rast, kam thënë që Komisioni i Politikës së Jashtme duhet të jetë komisioni përgjegjës. Meqenëse kemi pasur procedurë relativisht të përshpejtuara, për shkak të dëshirës që kemi pasur për të qenë një ndër vendet e para që e ka ratifikuar këtë marrëveshje, ju kujtoj se Greqia e ka ratifikuar protokollin të premtën e kaluar, Bullgaria këto ditë dhe dje Sllovakia...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kështu që zonja zëvendësministre fjala është për ju dhe më pas për zotën Koçi, në qoftë se ka diçka për të shtuar. Më pas do të kalojmë në pyetje, komente dhe diskutime.

Faleminderit!

Artemis Dralo – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të bëj një përshkrim të shkurtër të këtij projektligji, i cili ka për qëllim ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili është nënshkruar më 6 shkurt të 2019-ës në Bruksel.

Paraqitja në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë e protokollit për ratifikim vjen në zbatim të nenit 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Traktati i Atlantikut të Veriut parashikon, në mënyrë të qartë, se vendimi për anëtarësimin e shteteve të reja merret me unanimitet nga të gjitha shtetet anëtare. Ftesa që iu akordua nga NATO Republikës së Maqedonisë së Veriut ka ardhur si një vlerësim për vullnetin e vazhdueshëm politik të vendit tonë fqinj për t’u anëtarësuar në NATO për reformat e ndërmarrë nga ky vend, për përpjekjet në përballimin sfidave të sigurisë, si dhe për angazhimin

për të përfunduar marrëveshjen historike me shtetin grek lidhur me ermin. Këtu më lejoni të nënvizoj rolin konstruktiv dhe mbështetës që faktori shqiptar në Maqedoninë e Veriut i ka dhënë procesit të anëtarësimit të këtij vendi në NATO.

Rotacioni politik në vendin fqinj, kryesisht arritja e Marrëveshjes së Prespës për çështjen e emrit me Greqinë, i ka nxitur vendet anëtare të NATO-s, në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të aleancës, i cili është mbajtur në datat 11 dhe 12 korrik 2018, që t'i akordojnë Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u anëtarësuar në NATO.

Ratifikimi i protokollit të anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO në aspektin politik është në zbatim të plotë të politikës së NATO-s të dyerve të hapura. Gjithashtu, përbën një shembull të qartë të parimit politik dhe demokratik se çdo shtet sovran ka të drejtën e pakundërshtueshme për të zgjedhur në mënyrë të lirë aleancat e veta.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka bërë një rrugë relativisht të gjatë drejt anëtarësimit në NATO. Nëse më lejoni, dua të përshkruaj përpjekjet institucionale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për të arritur anëtarësimin në NATO. Ato kanë filluar qysh herët, me anëtarësimin në nismën e partneritetit për paqe më 15 nëntor 1995. Në atë kohë ish-Maqedonia u pranua në këshillin e bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut, i cili u pasua më pas në vitin 1997 nga këshilli i partneritetit euroatlantik. Më 14 qershor të vitit 1996 në Shkup u hap zyra për ndërlidhjen e NATO-s dhe në fund të '97-s u hap në selinë e NATO-s misioni i përhershëm i Maqedonisë. Në prill të vitit 1999 në samitin e NATO-s në Uashington, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë mori statusin e vendit kandidat për anëtarësim dhe që prej asaj kohe filloi pjesëmarrja e vendit në planin e veprimit të anëtarësimit.

Republika e Maqedonisë së Veriut është vlerësuar pozitivisht nga vendet aleate për pjesëmarrjen e saj në misionet ndërkombëtare paqësuese, duke filluar që nga viti 2002 me misionin ISAF në Afganistan, si dhe më pas në vitin 2006 në misionin e BE-së ALTHEA, në Bosnje dhe në Hercegovinë.

Për sa i përket rrafshit të sigurisë, ky anëtarësim ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e sigurisë në hapësirën euroatlantike, si dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Anëtarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO redukton më tej influencën e fuqive të treta në rajonin tonë, si dhe ndikon ndjeshëm në forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë. Ashtu siç e kanë bërë të qarta vendet anëtare të NATO-s, procesi i reformave në Republikën e Maqedonisë së Veriut duhet të vazhdojë jo vetëm gjatë periudhës së anëtarësimit, por edhe më pas. Ky është një proces në vazhdimësi, që synon bërjen shtet anëtar i NATO-s me aftësi të plota.

Gjithashtu, vendet aleate kanë bërë të ditur se dëshirojnë të shikojnë përparim në lëmin e reformave në sektorin e inteligjencës dhe të sigurisë, të sundimit të shtetit ligjor, pavarësisë së gjyqësorit, si dhe aftësive mbrojtëse të vendit. Me hyrjen në fuqi të këtij protokoll nga të gjitha vendet anëtare sekretari i Përgjithshëm i NATO-s i komunikon qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u pranuar në Traktatin e Atlantikut të Veriut. Në përputhje me nenin 10 të traktatit Republikës së Maqedonisë së Veriut bëhet palë në të vetëm kur depoziton instrumentin e anëtarësimit në qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që është edhe depozituese e traktatit.

Protokollin hyn në fuqi kur secila nga palët e Traktatit të Atlantikut të Veriut të ketë njoftuar për vendimin e marrë qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Për Republikën e Shqipërisë kjo procedurë do të ndiqet pas hyrjes në fuqi të ligjit të ratifikimit të këtij protokoll. Shpresojmë në seancën e radhës, ditën e enjte, dhe bie që të jemi shteti i katërt, megjithëse konsiderohemi nga shtetet e para. Nëpërmjet këtij ratifikimi Republika e Shqipërisë bëhet ndër vendet më të rëndësishme të aleancës, që shprehet pozitivisht për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Faleminderit për vëmendjen!

Mimi Kodheli - Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Zoti Koçi, a keni ndonjë gjë për të shtuar?

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuara zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

Vetëm dy fjalë, meqenëse zëvendësministrja Dralo foli qartë dhe përfaqëson ministrinë lider në miratimin e këtij projektligji.

Dua të them se anëtarësimi i Maqedonisë së Veriut në NATO është një investim i drejtpërdrejtë për interesat gjeostrategjike të Shqipërisë dhe të shqiptarëve në rajon. Të mos harrojmë që në Maqedoninë e Veriut banon një popullsi e konsiderueshme shqiptarësh. Kjo do të thotë se ata më në fund do të jenë pjesë e NATO-s, sepse, së pari, NATO-ja, nuk është një organizatë ushtarake, por është një organizatë politike. Sigurisht, është një investim i drejtpërdrejtë për demokracinë dhe shtetin ligjor në Maqedoninë e Veriut, domethënë edhe në interes të shqiptarëve, të cilët ishin faktori deciziv në përkushtimin euroatlantik të vendit, sidomos në procesin e negociimit me Greqinë për çështjen emrit. Për shkak të zhvillimeve politike në Maqedoninë e Veriut, faktori shqiptar ishte deciziv.

Nga ana tjetër, me përfundimin e këtij procesi, pra të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, atëherë ishulli që nuk është pjesë e NATO-s zvogëlohet dhe këtu ne kemi

interes të drejtpërdrejtë për Kosovën, që do të thotë energji dhe vëmendje e posaçme, pra tashmë do të këtë mundësi që t'i drejtohet Kosovës.

Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Koçi për prezantimin!

Zoti Bushati është relatori i këtij projektligj.

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ditmir Bushati - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit kolegë për prezantimin e kësaj nisme!

Në radhë të parë, dua të ndaj opinionin tim, siç e tha edhe zoti Shehu, që komisioni përgjegjës për këtë projektligj duhej të ishte normalisht Komisioni për Politikën e Jashtme. Ashtu si në vitin 2015, por edhe në këtë relacion të sjellë nga Këshilli i Ministrave, siç e tha edhe zoti Koçi, institucion përgjegjës për këtë nismë është Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme.

Në fakt, para së gjithash, NATO është një organizatë politike dhe besoj se ky gabim i Konferencës së Kryetarëve shpresoj të këtë qenë thjesht një lapsus, jo një gabim konceptual. Këtu çështja nuk qëndron nëse do ta kalojmë me konsensus apo jo këtë akt, sepse besoj se asnjëri nga ne nuk ka dyshimin më të vogël në përkatësinë atlantiste të klasës politike shqiptare apo të paktën të konfigurimit aktual të parlamentit shqiptar, por kjo është një çështje që ka të bëjë me mënyrën se si konceptohet kjo organizatë dhe prania jonë në këtë organizatë.

Së dyti, mendoj se është e domosdoshme që relacioni dhe raporti i këtij komisioni duhet të jetë sa më i qartë, sepse ka lidhje me interesin strategjik të Shqipërisë. Për fat të keq, kjo gjë mungon në relacionin e ardhur nga Këshilli i Ministrave. Unë e kam lexuar me shumë vëmendje dhe duket sikur kemi të bëjmë thjesht me një dokument klasik, me një marrëveshje të radhës, që vjen në parlament për t'u ratifikuar. Kjo është edhe arsyeja që, me vullnet të plotë, nuk kam ndër mend të lexoj relacionin e përgatitur sot këtu, as të citoj nenet e Kushtetutës, sepse secili nga ne e di qoftë nenin përkatës të Kushtetutës, qoftë nenin përkatës që ka lidhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Unë mund t'ju them, duke u nisur nga konstatimi në relacion, ku flitet për Maqedoninë si vendi kandidat për t'u futur në NATO pas Samitit të Uashingtonit, se është një lapsus dhe mbase është ngatërruar me procedurat që ka procesi i anëtarësimit në Bashkimin Europian. Ne fare mirë mund t'u kthehemi dokumenteve kryesore themeluese të NATO-s, apo procesit që ka kaluar Shqipëria dhe vendet e tjera të ngjashme, apo procesit të fundit që kaluam para dy vjetësh me Malin e Zi, ku dimë se ka një ftesë për të filluar procesin e bisedimeve dhe para kësaj ftese, natyrisht, janë procedurat që kanë të bëjnë me *map*-et dhe me ciklin e *map*-ve, që u përmendën edhe këtu gjatë prezantimit.

Së treti, është shumë e rëndësishme jo vetëm në raportin e këtij komisioni, por edhe në raportin që do të keni ju, zonja kryetare, në Kuvend, për ta përcaktuar qartë, pasi në relacion nuk përmendet Marrëveshja e Ohrit. Në rast se flasim për interesin tonë strategjik në rajon, kjo nuk është një garë midis vendit tonë, Sllovakisë, Greqisë dhe Bullgarisë, se cili nga ne do ta ratifikojë i pari këtë marrëveshje. Por krahas përkufizimit të rolit dhe peshës së aktorëve të tretë në rajon, me ankorimin e Shkupit në NATO, interesi strategjik i Shqipërisë dhe politika shtetërore e Shqipërisë, e konfirmuar nga të gjitha qeveritë e pas viteve '90, ka të bëjë me avancimin e të drejtave të shqiptarëve atje.

Dëgjova përfaqësuesit e qeverisë, të cilët thanë se Shqipëria ka një politikë shtetërore në këtë pikë, por këtu nuk po flasim as për sasi dhe as për prezencë të shqiptarëve, por po flasim për shqiptarët si një nga dy komunitetet shtetformuese në Shkup. Kjo është pjesë e programit të politikës së jashtme të kësaj qeverie, që e kemi miratuar të gjithë në Kuvend, të paktën ne të maxhorancës, e cila është konfirmuar në Samitin e Uellsit dhe që duhet të jetë pjesë e dokumenteve të Kuvendit, meqenëse nuk është pjesë e relacionit të sjellë nga Këshilli i Ministrave.

Në vitin 2014 është bërë një betejë e gjatë për të përfshirë Marrëveshjen e Ohrit si kriter për avancimin e vendit në NATO, ndaj kjo duhet të figurojë zyrtarisht si dokument i Kuvendit të Shqipërisë. Ndërkohë, ne po presim që të vijë edhe zoti Xhaferri, i cili do të flasë për këtë çështje.

Unë besoj fuqimisht se duhet të jetë pjesë e relacionit tonë qëndrimi i SECP-së, deklarata zyrtare e presidencës shqiptare në vitin 2015, pikërisht në mbështetje të interesit të shqiptarëve në Shkup për të avancuar më tej me Marrëveshjen e Ohrit; është edhe deklarata e 24 gushtit të viti 2015, e takimit tripalësh Shqipëri- Maqedoni asokohe dhe Bullgari, në konfirmim po të këtij qëndrimi; është deklarata zyrtare e dhjetorit të vitit 2017, në përfundim të takimit të përbashkët të dy qeverive të mbajtur në Pogradec, ku në pikën 8 flitet qartë për detyrimet që ka vendi fqinj në funksion të jetësimit të Marrëveshjes së Ohrit. Këtë e lidh, po e përsëris, me kriterin që u përcaktua në Uells në vitin 2014 për të vazhduar më pas me vetë platformën politike të partive shqiptare në Maqedoni e kështu me radhë.

Prandaj, duke përfunduar këtë pjesë, që ka lidhje me substancën e kësaj marrëveshjeje që ne do të kalojmë sot, duke mos i hequr asnjë presje pjesës substanciale që ka bërë Departamenti i së Drejtës Ndërkombëtare në Ministrinë e Jashtme, unë mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm për ta bërë siç duhet këtë dokument, sepse ka të bëjë me politikën tonë shtetërore dhe nuk është thjesht një marrëveshje ndërkombëtare e radhës, që ne po e kalojmë sot këtu.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Dua të nënvizoj se për shkak të precedentit të krijuar, e ripërsëris, dy vjet e ca më parë, lidhur me faktin se cili komision do të ishte përgjegjës, do të ishte problematike, mbase, që ky precedent të thyhej dhe të vihej në udhë të drejtë, ashtu si të gjithë biem dakord, që Komisioni për Politikën e Jashtme duhej të ishte komisioni përgjegjës. Shkak i këtij precedenti vazhdon ta mbajë në këtë linjë edhe procedurën e ratifikimi të protokollit të traktatit të Atlantikut të Veriut për rastin e Maqedonisë, duke pasur parasysh rastin e Malit të Zi më parë.

Urdhëroni, nënkryetar!

Tritan Shehu - Faleminderit!

Unë do ta ndaja në dy pjesë fjalën time.

Së pari, pa dyshim, do të deklaroj votim pro, jo vetëm timen, por të të gjithë kolegëve, besoj, sepse ngjarja e sotme është një ngjarje e madhe. Të arrihet të ratifikojmë hyrjen e Maqedonisë së Veriut në NATO është një ngjarje e madhe, e shumëpritur, pas shumë përpjekjeve të bëra në shumë vjet.

Ndaj të njëjtin mendim me zotin Bushati për ato që tha, pikërisht sepse këtu nuk kemi të bëjmë me një grup shqiptarësh, por kemi të bëjmë me një përpjekje të madhe, të një popullsie të tërë, e cila u bë forca vendimtare për futjen e Maqedonisë së Veriut në NATO.

Pa vullnetin, pa forcën, pa insistimin, pa përpjekjet e mëdha, pa Marrëveshjen e Ohrit nuk mund të arrihej sot në këtë ditë që ai vend të ishte vend anëtar i NATO-s. Të gjithë i dimë vështirësitë, interferencat e brendshme apo të jashtme për ta penguar këtë proces, por më në fund kjo u arrit.

Unë e konsideroj një ngjarje të madhe dhe shumë të rëndësishme për atë vend, për Shqipërinë dhe për rajonin, për shqiptarët kudo që janë. Përfitoj nga rasti dhe dua të bëj një homazh këtu që nga Arbër Xhaferri deri të kolegu ynë që është në krye sot, Ali Ahmeti, për gjithë çka kanë bërë në këtë periudhë dhe që kanë arritur deri këtu, jo thjesht futjen e atij vendi në NATO, por edhe ndryshimin e fundit kushtetues, ku u arrit që edhe gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare dhe kjo ka një domethënie të madhe. Ky fakt tregon atë çka bëri faktori shqiptar shtetformues në atë vend.

Nga ana tjetër unë dua t'ua kujtoj të gjithëve se për këtë gjë ka një kontribut të madh politika jonë si Shqipëri, që nga viti 1992, me forcimin e stabilitetit në rajon, duke qenë faktori kryesor i stabilitetit në rajon, politika jonë, e cila konsiston dhe ka konsistuar gjithmonë vetëm me një vizion për integrimin rajonit në BE, për ruajtjen e tërësisë territoriale të çdo vendi, për moshapjen përsëri të konflikteve të mëdha të ndryshimit të kufijve, politikë e bazuar në

principin e zhvleftësimit të kufijve në rrugën e integritit europian dhe në zerimin e tyre pastaj, kur ne të gjithë bashke jemi brenda BE-së.

Çdo devijim nga kjo politikë, pa dyshim do të ishte një aventurë e rrezikshme që do të largonte nga NATO-ja, jo vetëm ne, por edhe vende të tjera që u futën sot, por që përsëri do të paraqitnin një rrezikshmëri nga atë, të cilët e gjenerojnë si pasojë e një teorie shumë të rrezikshme të Beogradit, që nga argatët e tyre në Prishtinë dhe në Tiranë dhe me pupacët e vendosur në krye të ministrive tonë kërkojnë të na devijojnë nga rruga jonë e stabilitetit rajonal.

Në këtë kuptim unë dhashë votën pro dhe u deklarova qetësisht për këtë gjë, por dua të them pjesën tjetër. Fatkeqësisht, ngjarja e sotme, diskutimi i sotëm, relacioni i sotëm kanë një domethënie.

Unë nuk e konsideroj lapsus heqjen e Komisionit të Jashtëm si faktori kryesor. Unë nuk e konsideroj lapsus relacionin e paraqitur, i cili është një dizastro e vërtetë, pavarësisht se ne do ta miratojmë këtë proces. Unë nuk e konsideroj lapsus mungesën sot këtu të ministrit të ri të Jashtëm, i cili duhej të ishte këtu sot që të prezantohej, të prezantonte idetë e veta për Ministrinë e Jashtme, pavarësisht se mund të jetë edhe Kryeministër, padyshim, të paraqiste edhe këtë arritje të madhe.

Zoti ministër i Jashtëm nuk ka nevojë të fshihet skutave, zoti ministër i Jashtëm nuk ka pse të zhduket, zoti ministër i Jashtëm nuk ka pse të shtyjë që të hiqet roli kryesor i Komisionit të Jashtëm, ku duhej të vinte vetë ai dhe nuk kishte pse ta fuste Ministrinë e Jashtme në të tilla çrregullime, në të tilla anarki dhe të mos bënte veprime të tilla antikushetuese, të cilat rrezikojnë rëndë pozicionin e Shqipërisë, poziciononin tonë në NATO, marrëdhëniet brenda NATO-s dhe na bëjnë qesharakë edhe brenda NATO-s, edhe brenda BE-së, edhe me partnerët tanë, duke na bërë pastaj të humbim edhe rolin tonë lider që kemi pasur në rajon gjithë këto vjet për stabilitetin e rajonit, për t'i kaluar ky rol Serbisë dhe Vuçiqit.

Pra, unë e shoh me shumë seriozitet këtë gjë, e shoh si një gjë të përgatitur dhe të mirëmenduar, në suazën e pupacëve që janë vendosur për të çuar në një anarki të plotë, të re, ndoshta të gjithë rajonin.

Ne si opozitë do të paraqesim hapat tanë legalë për këtë gjë, brenda pak ditësh, dhe do të kërkojmë një diskutim të gjerë, por sot desha të shprehja indinjatën time dhe shqetësimin tim të madh për këtë devijim të funksioneve të Ministrisë së Jashtme, e cila në këtë mënyrë ndoshta mund të shkojë drejt zhdukjes së saj dhe të kalimit në një drejtori pranë kryeministrit. Mbase do të ishte më mirë kështu se, të paktën, nuk bëhemi më shumë qesharakë me pupacë gjithandej, duke i çuar në vend të ministrave.

Krahas vlerësimit dhe miratimit të plotë që kam dhe që kemi për marrëveshjen, unë shpreha sot këto shqetësime.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, nënkryetar!

Unë nuk e di për cilët pupacë e kishit fjalën, nënkryetar.

(Diskutime pa mikrofon)

Të mbaroj unë më parë.

E para, kjo nuk ishte pyetje.

E dyta, kjo ishte retorikë.

E treta, kërkoj këtu nga ana juaj që ofendimet t'i lëmë jashtë këtij ambienti ku ne punojmë, se nuk është një karakteristikë e këtij komisioni kjo gjë, përtej asaj çka ka kapluar klasën politike sot, që shpalos gjithë njohuritë që ka mbi fjalorin shqiptar.

Urdhëroni, zonja Hysi, për procedurë!

Vasilika Hysi – Procedurën e kam për gjuhën dhe etikën e komunikimit në këtë komision. Ndihej e keqardhur që profesor Shehu përdori këtë terminologji. Është e rëndë, aq më tepër që po diskutojmë një çështje që ka interes publik. Në bazë të Kodit të Sjelljes nuk lejohet gjuha joparlamentare, prandaj do të kërkoja që të kërkonit ndjesë për gjuhën që përdorët.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zoti Shehu, ju e merrni fjalën kur t'jua jap unë. Zonja Hysi foli për procedurë.

(Diskutime pa mikrofon)

Tritan Shehu – Së pari, unë mendoj se ndjesë duhet të kërkojnë ata, të cilët marrin dekretet e Presidentit sikur të jenë karta bakalli, i marrin dhe ia japin tjetrit krejt pa problem.

Posti i ministrit, zonjë, është post nominal, përgjegjësitë janë nominale, atributet janë nominale dhe ai që e pranon, padyshim që kthehet në një pupac.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Ervin Bushati!

Ervin Bushati – Më vjen mirë që të kemi lartësinë e pozicionit që na jep detyra dhe komisioni për këtë mbledhje solemne dhe duhet të rrimë në lartësinë e këtij solemniteti dhe të mos mbahemi mend si një mbledhje lapsus, se lapsus vetëm njëjës ka, nuk ka as shumës. Mos ta bëjmë edhe ne sikur jemi më të rëndësishëm se sa ngjarja para së cilës jemi sot, një ngjarje

historike për Shqipërinë, për Ballkanin, për NATO-në. Ko është një ditë shumë e rëndësishme në disa dimensione.

Mendoj se këtu duhet të thuhet fjalët më pozitive dhe kam përshtypjen se po të marrim edhe zbardhjen e asaj që është thënë në Komisionin e Jashtëm të Greqisë, duhet të ketë pasur diskutime më konstruktive në Greqi se sa diskutimet në komision tonë.

Është një lajm shumë i mirë ky, për Shqipërinë, në radhë të parë, është një lajm shumë i mirë për rajonin, patjetër edhe për NATO-n.

Ka më shumë nevojë Maqedonia, Ballkani dhe Shqipëria për NATO-n, se sa ka nevojë NATO-ja për Maqedoninë, për Shqipërinë apo për Ballkanin, sepse nuk është thjesht një aleancë ushtarake, por është një garanci paqeje dhe prosperiteti në një zonë si Ballkani, për një shtet si Shqipëria, apo edhe Maqedonia, shtete të vogla që gjithmonë kanë qenë në udhëkryqin e përplasjeve të mëdha historike, etnike, territoriale. Garancia e ombrellës së NATO-s është një vlerë shumë më e madhe se sa për shtetet e tjera, që janë të mëdha dhe mund të mbahen thjesht me peshën dhe sigurinë e tyre.

Është një vulë për Ballkanin dhe gjithë territorin, aq më tepër që vjen në një moment historik për të gjithë ne, ka të bëjë me integrimin në një shoqëri më të drejtë, në një shoqëri bazuar mbi shtetin ligjor, në një shoqëri me parime europiane, më të integruar në NATO dhe më të integruar në BE.

Kjo është një ditë e madhe për Shqipërinë, për shqiptarët, për rajonin, sepse, po të kemi parasysh, në prill të vitit 2017, në atë që u quajt “e enjtja e përgjakshme”, forcat regresive u përpoqën të ndalin procese të tilla, ashtu siç do të përpiqen edhe në të ardhmen të ndalin procese të tjera integruese të Ballkanit, të shqiptarëve në NATO, në BE. Pra, sot jem në një ditë të madhe. Në më pak se dy vjet Maqedonia ka bërë një progres të tillë të admirueshëm, të mrekullueshëm, është një progres i vërtetë, sepse para dy vjetësh Maqedonia ishte në një udhëkryq të rrezikshëm, ndërsa sot ne jemi në një ditë të madhe, historike për rajonin, për shqiptarët, kështu që shpresoj të kalojmë sa më shpejt në votim. Le t’i lëmë diskutimet patriotike, të mëdha, frymëzuese për në seancë dhe të ruajmë frymën e pozitivitetit dhe të solemnitetit që ka kjo mbledhje sot.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, deputeti Ervin Bushati!

Udhëroni, nënkryetarja Gjoshë!

Klajda Gjoshë – Faleminderit, zonja kryetare!

Në mënyrë absolute këtu nuk ka asnjë diskutim nëse do të votohet pro apo kundër. Jo vetëm në Komisionin e Politikës së Jashtme, por mendoj në Kuvendin e Shqipërisë të gjitha

votat, 140 vota do të shkojnë pro këtij traktati jashtëzakonisht të rëndësishëm për aderimin të Maqedonisë së Veriut në NATO, por që i hap rrugë, pse jo, edhe procesit të integritetit të këtij vendi, i cili ka vuajtur ndër vite.

Unë mendoj se marrëveshja e arritur së fundmi ka qenë jo vetëm historike, por ka qenë edhe e jashtëzakonshme, ka qenë me sakrifica shumë të mëdha nga vetë politikanët e Maqedonisë së Veriut, por edhe nga faktori shqiptar dhe këtu bie plotësisht dakord me zotin Bushati, relatorin e kësaj çështjeje, që patjetër kjo do të duhet të theksohet në relacion.

E ftoj Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme që ta rishikojë, ta plotësojë relacionin, sepse ka rëndësi të veçantë për t'i dhënë faktorit shqiptar atë që, në fakt, meriton, rëndësinë e arritjes së kësaj marrëveshjeje historike. Kjo nuk është për linjë patriotike. Nuk mbahem si ndonjë politikane nacionaliste apo me gjuhë të theksuar nacionaliste, por mendoj që është e denjë që në relacion patjetër të citohet dhe të vendoset roli i faktorit shqiptar në gjithë këtë arritje dhe marrëveshje kaq të rëndësishme.

Kjo nuk është një marrëveshje kuadër, nuk është diçka që shpeshherë ne e shohim *copy-paste* në marrëveshjet e tjera që vijnë dhe kalojnë në këtë komision. Edhe unë ndaj të njëjtin mendim me zotin Shehu, që patjetër do të kishim dashur prezencën e ministrit në këtë komision, i takonte, në fakt, të prezantohej ky traktat nga ministri i ri për Europën dhe Punët e Jashtme, i cili, fatkeqësisht, e dorëzoi detyrën në pak minuta. Po, mendoj se kjo marrëveshje e meritonte ardhjen e tij në këtë Komision edhe për vetë rëndësinë që ajo ka.

Votat tona janë pro, por besoj se duhen pranuar edhe disa kritika që e bëjnë më të mirë politikën tonë të jashtme dhe nuk e dëmtojnë atë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, nënkryetare!

Me thënë të drejtën, këtu në Komisionin e Politikës së Jashtme ka dy ministra që kanë qenë pjesë e Samitit të Uellsit, ku janë vendosur disa piketa të rëndësishme që lidhen me Marrëveshjen e Ohrit dhe jo vetëm, kështu që ky komision e tejkalon prezencën e njerëzve që pasur modestisht dorë në arritjen këtu ku jemi sot dhe për çka po diskutojmë.

Edhe ju, zoti Koçi, keni qenë zëvendësministër dhe e keni ndihmuar ish- ministrin e Mbrojtjes në këtë proces. Ky nuk është rasti i zonjës zëvendësministre apo gjithë zotërinjtë e tjerë këtu prezentë, ushtarakë dhe drejtorë, e dinë për çka po flas.

Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

Petro Koçi – Sigurisht, ka qenë kënaqësi, zonja Kodheli, të bashkëpunojta me ju.

Më lejoni, së pari, të them se mungesa e të gjitha argumenteve në relacionin shoqërues, sigurisht që justifikohet me procedurën e përshpejtuar që është ndjekur në rastin e miratimit të

këtij protokollit për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, por unë besoj se diskutimi i ish-ministrit Bushati ishte vërtet shterues dhe unë e mbështes për gjithë argumentet që hodhi si relator i këtij projektligji, por unë besoj se nuk është lapsus, do të shpresoja të jetë lapsus fakti që Shqipëria paskësh ndjekur politikën e mosndryshimit të kufijve që nga '92-shi, që nga koha e Jugosllavisë. Në qoftë se do të ndiqej kjo politikë, sot nuk do të kishim një Kosovë të pavarur, por do të kishim një realitet, i cili do të ishte ndryshe, për sa u përket gjithë interesave, jo vetëm gjeostrategjike, por edhe interesave të ditës së shqiptarëve.

Kështu që, unë e kuptoj interesin për patriotizëm të opozitës, lidhur me debatin që po zhvillohet për një ide të hedhur nga presidenti Thaçi për korrigjim kufijsh mes Serbisë dhe Kosovës, por unë besoj se kjo është një temë tjetër dhe nuk është vendi sot për ta përmendur.

Le të shpresojmë që kjo çështja e '92-shit vërtet të jetë një lapsus.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Unë dua të komplimentoj kolegun Ervin Bushati, që tha se, nga latinishtja, fjala “lapsus” nuk ka shumë. Duhet të kesh njohuri të thella në latinisht që e di këtë gjë.

Është e drejtë që të vij në momentin e miratimit të këtij projektligji.

Unë ju falënderoj sinqerisht për çka diskutuam!

Kush është dakord me projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”?

Miratohet.

Neni 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Votojmë projektligjin në tërësi.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit, për prezencën!

Mbyllet mbledhja.

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

